

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga çlirimtar në “zog në kafaz” për të trembur Putinin dhe Netanyahu, ANALIZA e Ben Blushit: Pse u sa krifikua Hashim Thaçi në Hagë?
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/nga-clirimtar-ne-zog-ne-kafaz-per-te-trembur-putinin-dhe-netanyahun-a-i401381
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:54:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	69f8409b5156effa35cf390b3fb96f8726b9269624d6e6701be4f234fe162a4a
TEKSTI	0cc20782443f2fc6425581c26bfa916f07d31d8cc55e214e912e53dc92b89630
PAMJA	dbd11957f17add7e5f81e7952f0bad7383178d5ce7da3e374b53d8a82e9d3a15

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b248919b7c4b0cd5a688e0c55641a899e144da88b4b7c4e3e705f03531d65404
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	78d6084bfd6cb1be1efaeb014ade0ef1539709e636c33f39308264a405fee6e2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b248919b7c4b0cd5a688e0c55641a899e144da88b4b7c4e3e705f03531d65404>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

16 Shtator 2026, 19:45

Nga çlirimtar në "zog në kafaz" për të trembur Putinin dhe Netanyahu, ANALIZA e Ben Blushit: Pse u sakrifikua Hashim Thaçi në Hagë?



Shkruar nga Newsbomb



Hashim Thaçi dhe Ben Blushi

Shkrimtari dhe gazetari Ben Blushi përmes një statusi të postuar në rrjetet sociale ka reaguar lidhur me dënimin e dhënë ditën e sotme nga Gjykata e Hagës për Hashim Thaçin, i cili u dënua me 25 vite burg për krime kundër njerëzimit.

Blushi në shkrimin e tij sheh më të thellë dënimin e Thaçit dhe e lidh atë me interesat globale. Teksa shprehet se ish-kryeministri i Kosovës u dënua si politikan e jo si vrasës, ai ka shkruar: *"Dyshimet, faktet, provat, dëshimtarët, mbrojtja dhe raportet ndërkombëtare nuk kanë asnjë rëndësi për këta njerëz. Ata nuk japin vendime nisur nga provat, por nisur nga interesat globale."*

Më tej Blushi e lidh fatin e Thaçit me dështimin e rendit liberal dhe luftërat e reja në botë. Ai thotë se sa herë që Rusia avanconte apo Izraeli godiste, presioni mbi Thaçin shtoej për të treguar forcën e drejtësisë ndërkombëtare. Sipas shkrimtarit arrestimi i Thaçit nisi si një hakmarrje e liberalëve, pas takimit të tij me Trump në Shtëpinë e Bardhë.

Më tej në shkrimin e tij ai e ka krahasuar Thaçin me një zog të futur në "kafaz" nga ndërkombëtarët, për të "trembur tigrat e arinjte", si Putin apo Netanyahu.

"Pasi u rrëmbye nga tavolina e Donald Trumpit, Hashimi u përdor për të trembur dy armiq të mëdhenj të liberalëve. Putinin dhe Netanyahu."

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Bota

Haga dha 81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, reagon Marta Kos: Vendimet e saj duhet të respektohen



Sporti

Gjykata e Hagës i dënoi me 81 vite burg, klubi i Superiores mesazh ish-krerëve të UÇK-së. Historia nuk harrohet, sakrificat nuk shuhet

Zbuloni më shumë artikuj >

Është komike të mendosh se futja e një zogu në kafaz, mund të trembë tigrat dhe arinjtë e një pylli të cmendur, por gjuetarët përdorin të njëjtat mjete kundër të gjitha kafshëve. Kafazët.”, shkruan Blushi

Ndërsa në përfudnim të shkrimit të tij ai është shprehur se Thaçi, është sakrifikuar për të mbajtur në këmbë kolonat juridike të rendit liberal perëndimor, por e mbyll me shpresën se “si politikan u dënua dhe si politikan do të lirohet”.

Shkrimi i plotë i Ben Blushit:

PSE U DËNUA HASHIMI

Për fat të keq isha i bindur se Hashim Thaci dhe shokët e tij do dënoheshin.

Edhe vetë Hashimi e dinte.

Kur pashë fytyrën e tij prej guri në momentin që u shpall vendimi, kuptova se dhe ai nuk kishte asnjë dyshim.

Do dënohej sic u dënua.

Por ndërkohë që trishtimi nuk do i largohet më kurrë nga sytë, Hashimi e ka një ngushëllim.

Hashim Thaci nuk u dënua si vrasës, por u dënua si politikan.

Nuk u dënua nga gjykatësit e Hagës, por nga disa njerëz që nuk ishin fare aty.

Dyshimet, faktet, provat, dëshimtarët, mbrojtja dhe raportet ndërkombëtare nuk kanë asnjë rëndësi për këta njerëz.

Ata nuk japin vendime nisur nga provat, por nisur nga interesat globale.

Që kur Hashim Thaci është futur në burg bota ka ndryshuar shumë.

Pothuajse nuk njihet.

Rusia ka pushtuar Ukrainën, Izraeli ka pushtuar Gazën, Amerika ka sulmuar Iranin.

Evropa është më e dobët, Rusia më e egër, Amerika më e përcarë.

Luftërat e brendshme e kanë ndarë perëndimin më shumë se kurrë.

Liberalët janë kundër Rusisë dhe Izraelit, konservatorët janë pro.

Evropa është me gjysmën e Amerikës, kundër gjysmës tjetër.

Duket sikur rendi liberal po falimenton.

Demokracia nuk siguron më progres dhe unitet ideologjik.

Vendimi që mori Gjykata Speciale e Hagës është pasqyrë e ndarjes së thellë ndërkombëtare.

Gjysma e Evropës dhe Amerikës e donin Hashin Thacin në burg si aleat të gjysmës tjetër.

Vrasjet e pretenduara, torturat e civilëve dhe shtëpia me gjethe nuk u provuan, sepse dënimi nuk u bazua asnjëherë mbi prova.

Për çfarë duheshin provat?

Kur Hashim Thaci u nis në Shtëpinë e Bardhë për të takuar Trumpin, libelarët nuk kishin nevojë për prova të tjera.

Nëse Hashim Thaci ka bërë një gabim në jetën e vet, ky ishte i vetmi gabim.

Prandaj u arrestua.

Megjithatë nuk duhet të jetë pishman.

E kush nuk do ta bënte këtë gabim?

Por ndërkohë që u nis si një hakmarrje, vendimi kundër Hashimit ndryshoi rrugës.

Ai i ngjan pak atyre rasteve kur shtrigat që të kanë marrë peng, ta shtojnë dozën e helmët duke parë lëvizjen e reve.

Sa herë Rusia avanconte në Ukrainë, Hashimit ia shtonin dënimin, sa herë Izraeli vriste në Gaza dënimin dyfishohej, sa herë liberalët humbnin zgjedhjet, akuzat kundër Hashim Thacit forcoheshin.

Pasi u rrëmbye nga tavolina e Donald Trumpit, Hashimi u përdor për të trembur dy armiqtë më të mëdhenj të liberalëve.

Putinin dhe Netanyahu.

Është komike të mendosh se futja e një zogu në kafaz, mund të trembë tigrat dhe arinjtë e një pylli të cmendur, por gjuetarët përdorin të njëjtat mjete kundër të gjitha kafshëve.

Kafazët.

Ky krahasim cinik e bën dhe më të dhimbshëm rastin e Hashim Thacit.

Ndërkohë që ai cilroi vendin e vet, u krahasua me dy njerëz që kanë pushtuar vende të tjera.

Sado të krahasohet me tigrat dhe arinjtë, zogu mbetet zog edhe kur ha një milligonë.

Prandaj nuk është rastësi që Haga ka nxjerrë urdhër arresti ndërkombëtar për të tre.

Hashimi do ishte arrestuar kudo, kurse në Rusi dhe në Izrael Gjykata Ndërkombëtare nuk ka juridiksion.

Dhe pavarësisht se Gjykata Speciale e Kosovës nuk është pjesë e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, arkitektura e Hagës është po ajo.

Parimi mbi të cilin ngrihet kjo ngrehinë juridike parashikon që trupa gjykatësish ndërkombëtarë të dënojnë kur gjykatësit vendas nuk munden.

Për këtë shkak mandati i Hagës që arrestoi Hashim Thacin i ndjek nga pas edhe Putinin edhe Netanyahu të cilët nuk shkelin dot në shumicën e vendeve të botës.

Megjithëse Trumpi ka thënë disa herë se nuk e njeh Gjykatën e Hagës, liberalët dhe demokratët perëndimorë e përdorin si armën e tyre të fundit.

Gjykata Ndërkombëtare është forca e tyre.

Liberalët i mbajnë kollonat juridike të Hagës me thonj, sepse ajo e mbron rendin liberal nga armiqtë që e kërcënojnë.

Kjo është arsyeja pse Hashim Thaci u sakrifikua në themelet e kësaj gjykate.

Nëse Hashimi llohej, Gjykata do bësohej.

Ky është thelbi i këtij vendimi.

Kjo është arsyeja pse Perëndimi nuk i dëgjon fare thirrjet për luftën e Kosovës.

Perëndimi ka hallin e vet.

Ai kërkon të bëjë shembuj.

Perëndimi kërkon ta përdori Gjykatën e Hagës për tu mbrojtur.

Prandaj isha i sigurt se Hashim Thaci do dënohej.

Horoskopi i luftës ishte i gjithi kundër tij.

Nëse Donald Trumpi nuk do kishte ardhur në pushtet, Hashimi do ishte në punë, nëse bota do ishte në paqe, Hashimi do ishte president, nëse qeveritë e shkundura të Evropës nuk do ishin duke rënë, Hashim Thaci do ishte i lirë.

Prandaj megjithëse është i vrarë, ai duhet të jetë i qetë.

E di që do kishte zgjedhur të ishte dëshmor i Kosovës, por fatkeqësisht është dëshmor i rendit liberal që e çliroi Kosovën.

Si në legjendat greke ai po flijohet nga perënditë që e ndihmuan të bëhej i pavdekshëm.

Hashimi nuk u dënua për atë që ka bërë por për atë që mund të bëjë.

Botës nuk i duhej si president i një vendi të vogël, por si peng i një gjykate të madhe.

Prandaj duhet të jetë i qetë.

Ai nuk u dënua për dje por për nesër.

Nuk u dënua si vrasës por si politikan.

Dhe si politikan do lirohet.



Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





🕒 E Mërkurë 19:27

I plagosuri në Durrës me profesion avokat, blutë në kërkim të 61-vjeçarit që e plagosi me armë (FOTO)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.